



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

V E N D I M

Nr. 60, datë 29.08.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT
DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, të nenit 47, pikat 3 dhe 4 dhe të nenit 53 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullore “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI

Ylli Memisha

KRYETARI

Ardian Fullani

**BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

RREGULLORE

**“PËR KËRKESAT MINIMALE TË PUBLIKIMIT TË INFORMACIONIT NGA BANKAT
DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA”**

**(Miratuar me vendimin nr.60, datë 29.08.2008, ndryshuar me vendimin nr.25, datë
01.04.2015, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)**

**Kreu I
Të përgjithshme**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale, i mënyrave dhe afateve lidhur me informacionin që duhet publikuar në raportet periodike të bankave dhe degëve të bankave të huaja, në funksion të rritjes së transparencës dhe nxitjes së disiplinës në tregun bankar, si dhe për të siguruar qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e sistemit bankar.

**Neni 2
Subjektet**

Subjekte të kësaj rregullore janë bankat dhe degët e bankave të huaja (që më poshtë për thjeshtësi do të quhen me emrin e përbashkët “banka”), të cilat janë të licencuara të ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3
Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12 dhe shkronjës ”c”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar (më poshtë ligji “Për Bankën”) të nenit 53 dhe të nenit 55 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (më poshtë ligji “Për bankat”).

**Neni 4
Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit “Për bankat”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
- a) “Publikim” është vënia në dispozicion e informacionit për të gjitha kategoritë e përdoruesve¹: publikun, pjesëmarrësit e tregut, investitorët, punonjësit, kreditorët, klientët, qeveritë dhe organizmat e tjerë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;
 - b) “Informacion cilësor” është informacioni mbi objektivat, politikat dhe strategjitë e shkruara të bankës, metodat, proceset, strukturën, organizimin e funksionet e administrimit të rreziqeve, drejtimin² e bankës, politikat kontabël të përdorura, etj.;
 - c) “Informacion sasior” janë të dhënat numerike të përmbledhura për zërat e bilancit, për të ardhurat dhe shpenzimet, për madhësinë e ekspozimeve të bankës ndaj rreziqeve të ndryshme, klasifikimeve brenda portofoleve të kredisë, madhësinë e provigjoneve për humbjet kryesisht nga rreziku i kredisë, etj.;
 - d) “Informacion material” është informacioni, i cili nëse nuk pasqyrohet ose shtrembërohet, mund të ndryshojë ose të ndikojë në vlerësimin ose vendimin e një përdoruesi, që mbështetet në këtë informacion;
 - e) “Informacion privat” është informacioni për produktet, shërbimet dhe sistemet e informacionit të një banke, publikimi i të cilit mund të dëmtojë pozicionin konkurrues të bankës në treg;
 - f) “Informacion konfidencial” është informacioni mbi klientët dhe/ose palët e tjera që lidhin kontrata me bankën, dhe që ruhet si i tillë (konfidencial) në bazë të akteve ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

Neni 5

Kategoritë e informacionit

1. Bankat publikojnë raportet periodike që përfshijnë informacionin sipas gjashtë kategorive kryesore³:
- a) veprimtaria kryesore e bankës, organizimi dhe drejtimi i përgjithshëm;
 - b) ecuria (performanca) financiare;
 - c) gjendja financiare (duke përfshirë kapitalin, aftësinë paguese dhe likuiditetin);
 - d) praktikat dhe strategjitë e administrimit të rrezikut;
 - e) ⁴ekspozimet ndaj rreziqeve (duke përfshirë rrezikun e kredisë, rreziqet e tregut, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe rreziqet e tjera); dhe
 - f) politikat kontabël.

¹ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

² Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

³ Klasifikimi bëhet nga Komiteti i Bazelit.

⁴ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Bankat pasqyrojnë këto kategori të informacionit, në përputhje me natyrën, madhësinë, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të bankës⁵.
3. Informacioni që përfshihet në kategoritë e mësipërme paraqitet qartë dhe në mënyrë të përshtatshme, me qëllim që të arrihet një nivel i mjaftueshëm i transparencës bankare.
4. ⁶Bankat nuk publikojnë informacione të klasifikuara në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si konfidenciale ose sekret mbi klientelën e tyre, apo informacione që ndikojnë në pozicionin konkurrues të tyre në treg.

Neni 6

Kërkesat për procedurat e publikimit dhe karakteristikat e informacionit

1. Bankat hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për procedurat e përgatitjes dhe publikimit të informacionit, si dhe për kontrollin e brendshëm në procesin e përgatitjes dhe publikimit, me qëllim vlerësimin e përshtatshmërisë së publikimeve si vlefshmërinë, integritetin, saktësinë dhe frekuencën e tyre.
2. Aktet e brendshme të bankës për publikimin e informacionit përcaktojnë informacionin i cili do të klasifikohet material, privat dhe konfidencial, ndarjen e tij sipas kategorive të përdoruesve⁷, mjetet e tjera të komunikimit masiv që do të përdoren për publikim, përveç publikimeve me bazë letër, si dhe çështje të tjera me rëndësi për bankën.
3. Bankat publikojnë informacion mbi rreziqet ndaj të cilave ekspozohen në veprimtarinë e tyre, duke dhënë një pamje të *gjithanshme* të profilit të rrezikut.
4. Informacioni i publikuar nga bankat duhet të jetë material, që t'i shërbejë kërkesave vendimmarrëse të përdoruesve të tij dhe t'i ndihmojë ata në vlerësimin e rreziqeve dhe fitimeve të pritshme të investimeve të tyre, të ekspozimeve të tjera të mundshme dhe të ecurisë e të gjendjes financiare të ardhshme të veprimtarisë së bankave.
5. Bankat publikojnë informacionin me shtrirje kohore të mjaftueshme (periudha nga fundi i periudhës së raportuar deri në publikim), për të dhënë një pamje të kuptueshme të profilit të rrezikut të bankave dhe administrimit të tij.
6. Bankat publikojnë informacion të besueshëm, që pasqyron përmbajtjen ekonomike të ngjarjeve. Ky informacion duhet të jetë i verifikueshëm në çdo kohë, i plotë në të gjitha aspektet që paraqesin rëndësi për përdoruesin.
7. Bankat publikojnë të dhëna dhe tregues numerikë në raportet e publikuara, që kanë bazë krahasuese dhe që i referohen një ose disa periudhave të njëjta.

⁵ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁶ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Kreu II

Mënyra dhe afatet e publikimit të informacionit

Neni 7

Mënyra e publikimit të informacionit

1. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe në një mënyrë të përshtatshme (të tillë si broshura informative ose/dhe në formë elektronike apo të afishuar në një tabelë njoftimi) në ambiente të përdorshme nga publiku, në zyrat qendrore dhe në të gjitha degët dhe agjencitë e tyre.
2. Bankat publikojnë informacionin në faqen e internetit, e cila punon jo më pak se 95 për qind të vitit.
3. Bankat marrin masat, që informacioni të jetë në përdorim deri në publikimin tjetër të rradhës.
4. Bankat publikojnë informacionin në gjuhën shqipe dhe mbi baza vullnetare edhe në gjuhë të huaj.
5. Bankat përdorin si shenjë dalluese në publikimet e tyre stemën e bankës.

Neni 8

Afatet e publikimit

1. Bankat publikojnë informacionin sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, në raportet e tyre periodike.
2. Raporti i vlefshëm për periudhat tremujore (31 mars, 30 qershor dhe 30 shtator) publikohet brenda muajit pasardhës, pas mbarimit të tremujorit kalendarik. Ndërsa, raporti i tremujorit të katërt të vitit (31 dhjetor) publikohet brenda muajit prill⁸ të vitit pasardhës. Raporti i plotë vjetor, publikohet brenda gjashtëmujorit të parë të vitit pasardhës.
3. Bankat shënojnë datën në të cilën publikojnë raportin dhe datën kur plotësojnë ose korrigjojnë informacionin e publikuar më parë apo në rastin e publikimit të një informacioni shtesë apo plotësues, që i referohet të njëjtit informacion.
4. ⁹Informacioni sasior që publikohet në raportet periodike, përfshin informacionin për periudhën aktuale së bashku me informacionin krahasues për periudhat e mëparshme.
5. Bankat mund të publikojnë informacionin edhe në frekuenca më të shpeshta në varësi të rëndësisë së këtij informacioni¹⁰.

⁸ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

⁹ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹⁰ Shtuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Kreu III¹¹
Kërkesa raportuese dhe mbikëqyrëse

Neni 9
Kërkesa raportuese

1. Bankat publikojnë informacionin cilësor dhe sasior, sipas përmbajtjes dhe frekuencave të përcaktuara në tabelat e Aneksit 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Informacioni i paraqitur në secilën tabelë të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, i referohet një kategorie të caktuar informacioni.
3. Bankat dërgojnë në Bankën e Shqipërisë një kopje të publikimeve të tyre në formë elektronike, në përputhje me frekuencat e përcaktuara në këtë rregullore.
4. Banka e Shqipërisë, në çdo rast që e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë të kërkojë dhe të urdhërojë ndryshime në përmbajtjen dhe në shpeshësinë e publikimit.

Kreu IV
Dispozita përfundimtare

Neni 10¹²
Masa parandaluese dhe ndëshkimore

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenin 53, pika 5 dhe nenin 89 të ligjit “Për bankat” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Ardian Fullani

¹¹ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

¹² Rinumërtuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Aneksi 1¹³

Tabelë 1: Informacion mbi aktivitetin kryesor, organizimin, drejtimin dhe kontrollin e bankave

1.	Informacion i përgjithshëm mbi bankën (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).
1.1	Bankat publikojnë: <ul style="list-style-type: none"> a) emrin tregtar, formën juridike, adresën e regjistruar, numrin dhe datën e vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; b) shumën e kapitalit të regjistruar sipas vendimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit; c) shumën e kapitalit të paguar; d) tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara dhe vlerën nominale të tyre; e) informacion mbi rritjet e kapitalit, nëse ka rritje të tij që nga publikimi i fundit mbi: <ul style="list-style-type: none"> i) mënyrën dhe nivelin e rritjes së kapitalit, ii) tipin, formën, numrin e aksioneve të emetuara, vlerën nominale të tyre (në rastin e emetimit të një aksioni të ri), iii) shumën e rritjes së kapitalit, burimin (fondet) e rritjes (në rastin e rritjes së kapitalit nga fondet e veta) dhe nëse rritet vlera nominale e aksioneve, jepet shuma sipas të cilës ajo do të rritet.
1.2	Bankat publikojnë informacion mbi aksionerët që kanë pjesëmarrje influencuese. <ul style="list-style-type: none"> a) Në rastin e aksionerëve - persona juridikë, bankat publikojnë: <ul style="list-style-type: none"> i) emrin tregtar, ii) formën juridike, iii) adresën e regjistruar, iv) përqindjen e aksioneve me të drejta votimi. b) Në rastin e aksionerëve - persona fizikë, bankat publikojnë: <ul style="list-style-type: none"> i) emrin dhe mbiemrin, ii) përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.
2	Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime). Degët e bankave të huaja publikojnë: <ul style="list-style-type: none"> a) emrin tregtar, formën juridike, selinë, numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit; b) shumën e kapitalit të dhuruar; c) shumën e kapitalit të dhuruar, të paguar.
3	Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës dhe degës së bankës së huaj, duke përfshirë njësitë e saj funksionale dhe administrative, funksionet e tyre dhe marrëdhëniet raportuese dhe kontrolluese (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).
3.1.	Bankat publikojnë informacion mbi administrimin e bankës: <ul style="list-style-type: none"> a) strukturën organizative, numrin e njësive organizative dhe numrin e punonjësve; b) strukturën e organeve drejtuese si këshillit drejtues dhe drejtorisë, autoritetet dhe përgjegjësitë e tyre; c) kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve të këshillit drejtues, komitetit të kontrollit dhe drejtuesve ekzekutivë të bankave; d) strukturën e pronësisë (për shembull, aksionerët kryesorë dhe të drejtat e votimit),

¹³ Ndryshuar me vendimin nr.25, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

	pjesëmarrjen e aksionerëve kryesorë në këshillin drejtues ose në drejtorinë e bankës;
	e) kodin e etikës dhe politikën e drejtimit të veprimtarisë, në veçanti përmbajtja e ndonjë kodi apo politike qeverisëse dhe procesi sipas të cilit është zbatuar apo një vlerësim nga këshilli drejtues i performancës së tij lidhur me këtë kod ose politikë;
	f) politikën e bankës lidhur me konfliktet e interesave, si dhe natyrën dhe nivelin e transaksioneve me filialet dhe personat/klientët e lidhur.
3.2	Bankat publikojnë informacion mbi strukturën e grupit të konsoliduar, të cilit ato i përkasin (nëse ekziston grupi bankar):
	a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve që përbëjnë grupin e konsoliduar, ndërsa në rastin e personit fizik, jepet emri dhe mbiemri;
	b) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve në të cilat bankat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore;
	c) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar të sipërmarrjeve, të cilat janë sipërmarrje mëmë ose aksionere kryesore në banka.
4.	Informacion mbi aktivitetet e bankave (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).
	Bankat publikojnë informacion mbi aktivitetin e tyre si më poshtë:
	a) një listë të veprimtarive sipas licencës së marrë;
	b) një listë të veprimtarive që ato aktualisht kryejnë.
5.	Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrjet në të cilat bankat janë aksionere kryesore (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).
	Bankat publikojnë:
	a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar;
	b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e një sipërmarrjeje të tillë;
	c) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në të drejtat e votimit në një sipërmarrje të tillë;
	d) çdo mënyrë tjetër të kontrollit të ushtruar;
	e) numrin, vlerën nominale dhe çmimin e blerjes të aksioneve dhe çdo ndryshim të bërë gjatë periudhës aktuale;
	f) shumën e vlerave për t'u arkëtuar dhe për t'u paguar nga bankat në lidhje me një sipërmarrje të tillë;
	g) shumën e letrave me vlerë, të cilat janë lëshuar nga sipërmarrjet e tilla dhe shumën e vlerave të pagueshme nga letra të tilla me vlerë;
	h) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për sipërmarrje të tilla dhe shumën e garancive të pranuar nga bankat, nga sipërmarrje të tilla.
6.	Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksionere kryesore në banka (çdo fund viti dhe sa herë që ka ndryshime).
	Bankat publikojnë:
	a) emrin tregtar, formën juridike dhe adresën e regjistruar (në rastin e personit fizik jepet emri dhe mbiemri);
	b) përqindjen e pjesëmarrjes direkte ose indirekte, në kapitalin e bankave;
	c) përqindjen e pjesëmarrjes, direkte ose indirekte, të të drejtave të votimit të bankave;
	d) ndonjë mënyrë tjetër e kontrollit, e ushtruar;
	e) shumën e vlerave të arkëtueshme dhe të pagueshme të bankave ndaj sipërmarrjeve të tilla;
	f) shumën e letrave me vlerë të cilat janë emetuar nga sipërmarrje të tilla, dhe shumën e vlerave të pagueshme (<i>bank's payables</i>) nga këto letra me vlerë;
	g) shumën e garancive të lëshuara nga bankat për këto sipërmarrje dhe shumën e garancive të pranuar nga bankat për sipërmarrje të tilla.

7	Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë (çdo tremujor).
	Dega e bankës së huaj publikon raportet financiare tremujore dhe vjetore të bankës – mëmë si më poshtë:
	a) raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit;
	b) kapitalin rregullator (fondet e veta);
	c) treguesin e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë;
	d) treguesin e kredisë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator (fondet e veta);
	e) treguesin e shumës së fondeve rezervë për humbjet nga kreditë ndaj kredive me probleme;
	f) treguesin e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve;
	g) raportet financiare tremujore më të fundit të bankës-mëmë;
	h) raportin më të fundit të ekspertit kontabël të autorizuar për bankën-mëmë
	i) vlerësimin e performancës së bankës-mëmë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit (shoqëritë e <i>rating</i> -ut)

Tabelë 2: Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit (çdo tremujor)

Informacion cilësor	
	(a) Informacion përmbledhës, në formën e analizave dhe komenteve të shkruara, për ecurinë e gjendjes financiare të bankës.
Informacion sasior	
	(b) Bilanci kontabël (aktiv-pasivet) dhe zërat jashtë bilancit, shoqëruar me shënime sqaruese për zërat që i shërbejnë kërkesave të përdoruesve.
	(c) Pasqyra e llogarisë “të ardhura dhe shpenzime”, shoqëruar me shënime sqaruese mbi kategoritë e rëndësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve.
	(d) Tregues të rentabilitetit si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> i) kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto / aktivet mesatare *100; ii) rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare; iii) shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë; iv) të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë; v) kthyeshmëria nga kapitali aksioner mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100; vi) aktive për punonjës = totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve; vii) të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare; viii) marzhi neto nga interesat = të ardhurat neto nga interesat / aktive mesatare që sjellin të ardhura; ix) të ardhurat nga interesat / aktivet mesatare; x) shpenzime për interesa / aktivet mesatare; xi) të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë; xii) të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare; xiii) shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë; xiv) shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë; xv) shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.

Tabelë 3: Struktura e kapitalit rregullator (çdo tremujor)

Informacion cilësor	
	(a) Informacion përmbledhës mbi veçoritë kryesore kontraktuale të instrumentave të kapitalit dhe veçanërisht të instrumentave të borxhit të varur.
Informacion sasior	
	<p>(b) Kapitali i nivelit të parë, i llogaritur si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë.</p> <p>i) Kapitali bazë i nivelit të parë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kapitali i paguar (aksione të zakonshme); • primet e aksioneve (të zakonshme); • fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme; • fitimi ushtrimor i fundit të vitit; • fitimi ushtrimor i periudhës raportuese; • rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit); • diferenca rivlerësimi kreditore. <p>ii) Filtrat prudencialë dhe zbritjet nga kapitali bazë i nivelit të parë sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës” dhe/ose akteve të tjera rregullative.</p> <p>iii) Kapitali shtesë i nivelit të parë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • instrumentat e kapitalit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”; dhe • primet e emetimit të lidhura me instrumentat e mësipërm.
	(c) Totali i kapitalit të nivelit të parë
	<p>(d) i) Kapitali i nivelit të dytë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë; • primet e emetimit të lidhura me instrumentat e mësipërm; <p>ii) Zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.</p>
	(e) Totali i kapitalit të nivelit të dytë
	(f) Totali i kapitalit rregullator

Tabelë 4: Mjaftueshmëria e Kapitalit (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmblledhës mbi metodën standarde për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.
Informacion sasior		
	(b)	Zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
	(c)	<p>Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.</p> <p>Bankat llogarisin kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë e:</p> <p>i) kërkesës për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, e cila përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit; • kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit; dhe <p>ii) kërkesës për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e bankës (pozicionet në librin e tregtueshëm dhe pozicionet në librat e bankës), e cila përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit; • kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra (<i>commodities</i>); • kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.
	(d)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.
	(e)	Raporti i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun (në %).
	(f)	Raporti i Kapitalit të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun (në %).
	(g)	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (në %).

Tabelë 5: Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve*

Informacion cilësor	
	(a) Informacion përmblledhës mbi objektivat dhe politikat e administrimit të secilës kategori rreziku duke u ndalur në veçanti në: <ul style="list-style-type: none"> i) strategjitë dhe proceset për administrimin e këtyre rreziqeve; ii) strukturën dhe organizimin e funksionit të administrimit të rrezikut/qeve; iii) qëllimin dhe llojet e sistemeve të raportimit dhe matjes së rrezikut/qeve; iv) politikat e zbutjes së rrezikut, strategjitë dhe proceset për monitorimin e vazhdueshëm të efikasitetit të tyre.

*Frekuenca e publikimit të informacionit të kërkuar në tabelën 5, do të përshtatet sipas frekuencës së publikimit të secilës kategori rreziku, të detajuar në tabelat në vijim,

Tabelë 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm (çdo tremujor)

Informacion cilësor	
	(a) Informacion përmblledhës mbi rrezikun e kredisë që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> i) përkufizimin e kredive me probleme; ii) përshkrimin e metodës së përdorur për krijimin e fondeve rezervë për humbjet nga kreditë; iii) politikën e bankës për administrimin e rrezikut të kredisë.
Informacion sasior	
	(b) Teprica bruto e kredisë, teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore, sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë.
	(c) Klasifikime të portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike.
	(d) Klasifikime të portofolit të kredive sipas sektorëve të ekonomisë ose tipit të kundërpatisë.
	(e) Klasifikime të portofolit të kredive sipas maturitetit të mbetur (kontraktual).
	(f) Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (d), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	(g) Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (c), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
	(h) Ndryshimet në fondet rezervë për humbjet nga kreditë gjatë periudhës: <ul style="list-style-type: none"> i) teprica e fondeve rezervë në fillim të periudhës (+) ii) shtimi i fondeve rezervë (+) iii) rimarrje e fondeve rezervë (+) iv) kreditë e fshira gjatë periudhës (-) v) korrigjime të bëra gjatë periudhës (+ ose -) vi) teprica e fondeve rezervë në fund të periudhës (1+2+3-4+ose-5)

Tabelë 7: Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde
(çdo tremujor)

Informacion cilësor	(a)	Informacion përmbledhës për secilën klasë të ekspozimit sipas klasifikimit në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> i) emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA) si dhe arsyet e çdo ndryshimi; ii) klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur Institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA).
Informacion sasior	(b)	Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregulator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Tabelë 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut (çdo tremujor)

Informacion cilësor	(a)	Informacion përmbledhës mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> i) politikat dhe proceset për netimin/kompensimin në bilanc dhe jashtë bilancit, të shoqëruara me të dhëna mbi masën e përdorimit të netimit / kompensimit nga banka; ii) politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e kolateraleve; iii) përshkrim i kolateraleve kryesore të pranuar nga banka; iv) llojet kryesore të ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë dhe të aftësisë së tyre paguese; v) informacione mbi përqendrimin e rrezikut të tregut ose të kredisë brenda instrumentave të përdorura për zbutjen e rrezikut.
Informacion sasior	(b)	Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme) në rastin e përdorimit të mbrojtjes së financuar të kredisë që mbulohet nga: <ul style="list-style-type: none"> i) kolaterali financiar; ii) netimi në bilanc; iii) marrëveshjet tip të netimit/kompensimit; iv) mbrojtje të tjera të pranueshme. <p>(pas aplikimit të rregulimeve të luhatshmërisë).</p>
	(c)	Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe

	<p>jastë bilancit (nëse është e aplikueshme) në rastin e përdorimit të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, të mbuluara nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) garanci; ii) kundërgaranci; iii) derivativët e kredisë.
--	---

Tabelë 9: Rreziku i kredisë së kundërpartisë (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	<p>Informacion përmbledhës mbi derivativët dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) politikat lidhur me sigurimin e kolateralit dhe krijimin e fondeve rezervë për rrezikun e kredisë së kundërpartisë; ii) shumën e fondeve rezervë që banka krijon/planifikon, në rastet kur vlera e kolateralit bie për shkak të rënies së cilësisë së kredisë (<i>downgrading</i>).
Informacion sasior		
	(b)	<ul style="list-style-type: none"> i) vlera e drejtë pozitive bruto e kontratave; ii) zvogëlimi i vlerës së drejtë pozitive bruto si rrjedhojë e netimit / kompensimit; iii) vlera e drejtë pozitive neto e marrëveshjeve të netimit / kompensimit; iv) garancitë e marra; v) vlera e drejtë pozitive e kontratave derivative neto pas aplikimit të netimit / kompensimit dhe marrëveshjeve të garancisë; vi) vlera e ekspozimeve ndaj rrezikut të kundërpartisë, të llogaritura sipas metodës standarde; vii) vlera nominale (<i>notional</i>) e derivativëve të kredisë të përdorur për mbulimin e rrezikut të kundërpartisë; viii) shpërndarja e vlerës së drejtë pozitive të kontratave, sipas llojit të kontratave derivative; ix) vlera nominale (<i>notional</i>) e derivativëve në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm, të ndarë sipas produkteve dhe të detajuar sipas pozicionit që merr banka (blerës ose shitës i mbrojtjes) në fushën e secilit grup produktesh;

Tabelë 10: Titullzimi (çdo tremujor)

Informacion cilësor	
	<p>(a) Informacion përmblledhës mbi titullzimin (përfshirë këtu dhe titullzimin sintetik) që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) objektivat e bankës mbi veprimtarinë e titullzimit duke përfshirë shkallën me të cilën këto veprimtari transferojnë rrezikun e kredisë të aktivitetit bazë të titullzuar, nga banka në subjekte të tjera; ii) rolin që luan banka në procesin e titullzimit dhe shkallën e përfshirjes së saj në secilin proces titullzimi.
	<p>(b) Informacion përmblledhës mbi politikat kontabël të përdorura nga banka për operacionet e titullzimit që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) nëse transaksionet trajtohen si shitje ose financime; ii) njohjen e fitimeve nga shitja; iii) supozimet bazë për vlerësimin e interesave të përfutshme që përfshijnë çdo ndryshim të rëndësishëm që nga periudha e fundit raportuese dhe ndikimi i këtyre ndryshimeve; iv) trajtimin e titullzimeve sintetike nëse nuk mbulohen nga politika të tjera kontabël (për shembull derivativët).
	<p>(c) Emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) të përdorura për titullzimin dhe llojet e ekspozimeve në titullzime për të cilat është përdorur secili institucion.</p>
Informacion sasior	
	<p>(d) Shuma totale e operacioneve të titullzimit të realizuara nga banka në rastet kur banka është origjinuese e titullzimit, të ndara në titullzime tradicionale dhe sintetike dhe të atyre (operacioneve të titullzimit) në të cilat banka është investuese, sipas llojit të ekspozimit.</p>
	<p>(e) Për ekspozimet e titullzuara nga banka dhe subjekti i kuadrit rregullativ për titullzimin, sipas llojit të ekspozimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) shumën e aktiveve të titullzuara me probleme; dhe ii) humbjet e njohura nga banka në periudhën aktuale.
	<p>(f) Shuma agregate e ekspozimeve të mbajtura ose të blera në titullzime, të ndara sipas llojit të ekspozimit.</p>
	<p>(g) Informacion mbi vlerën agregate të ekspozimeve që i atribuohet interesave të origjinuesve dhe investitorëve në rastet e lehtësirave të titullzuara, që janë subjekt i trajtimit të shlyerjes së parakohshme.</p>
	<p>(h) Shuma e operacioneve të titullzimit për vitin aktual duke përfshirë shumën e ekspozimeve të titullzuara sipas llojit të ekspozimit dhe njohja e humbjeve ose të fitimeve nga shitja, sipas llojit të aktivitetit.</p>
	<p>(i) Shuma e pozicioneve të titullzimit të zbritura nga kapitali rregullator ose ato të cilat ponderohen me peshën e rrezikut 1250 %.</p>

Tabelë 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm (çdo gjashtëmuajor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmbledhës cilësor, për rreziqet e tregut sipas kërkesave të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
Informacion sasior		
	(b)	Kërkesa për kapital për: i) rrezikun nga normat e interesit; ii) rrezikun nga pozicionet në instrumentat e kapitalit; iii) rrezikun nga kursi i këmbimit; iv) rrezikun e pozicioneve në mallra (<i>commodities</i>).

Tabelë 12: Rreziku operacional (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmbledhës për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (Metoda e Treguesit të Thjeshtë ose Metoda Standarde).
Informacion sasior		
	(b)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuar në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuar me 12.5.

Tabelë 13: Ekspozimet në instrumenta të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmbledhës lidhur me investimet në aksione të përfshira në librin e bankës që përfshin: i) ekspozimet nga investimet në instrumentat e kapitalit (<i>equity</i>) të ndara sipas qëllimit të investimit (për shembull për realizimin e fitimeve kapitale, për marrëdhëniet me kundërpartinë, ose për qëllime strategjike); ii) përshkrim i politikave/teknikave kontabël dhe metodave të vlerësimit të përdorura, që përfshijnë supozimet bazë dhe praktikatat e përdorura që ndikojnë në vlerësimin si dhe ndryshimet e rëndësishme në këto praktika.
Informacion sasior		
	(b)	Informacion përmbledhës lidhur me investimet në aksione të përfshira

		në librin e bankës: i) vlera e bilancit dhe vlera e drejtë dhe për titujt e listuar, krahasimi me çmimin e tregut në rast se ekziston një diferencë e konsiderueshme me vlerën e drejtë.
	(c)	Llojet dhe shumat e ekspozimeve për: i) instrumentat e tregtueshëm në bursë; ii) instrumentat e emtuar përmes një oferte private të mbajtura në portofole të diversifikuar mjaftueshëm; iii) instrumente të tjera.
	(d)	Fitimet dhe humbjet kumulative të realizuara nga shitja dhe likuidimi gjatë periudhës raportuese.
	(e)	i) fitimet dhe humbjet e përealizuara, të njohura në bilanc por jo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; ii) fitimet dhe humbjet e përealizuara, të panjohura në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; iii) çdo shumë e fitimeve dhe humbjeve të përealizuara siç përcaktohet në pikat (i) dhe (ii), të kësaj shkronje, të përfshira në kapitalin e nivelit të parë dhe/ose të nivelit të dytë.

Tabelë 14: Rreziku i normës së interesit në librin e bankës (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmbledhës mbi ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit për pozicionet në librin e bankës, që përfshin: i) burimin/formën e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës; ii) supozimet bazë të përdorura për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës (përfshirë edhe supozimet për kreditë me një opsion shlyerjeje të hershme dhe sjelljen e depozitave pa afat); iii) frekuencën e matjes së këtij rreziku
Informacion sasior		
	(b)	Ndryshimi në të ardhurat ose tregues të ngjashëm të përdorur nga banka për <i>shock</i> -un pozitiv apo negativ të normës së interesit, në varësi të metodës së përdorur për matjen e rrezikut të normës së interesit, të ndarë sipas monedhave.

Tabelë 15: Rreziku i likuiditetit (çdo tremujor)

Informacion cilësor		
	(a)	Informacion përmbledhës sipas kërkesave të rregullores “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.
Informacion sasior		
	(b)	<ul style="list-style-type: none"> i) niveli i aktiveve likuide dhe burimeve e përdorimeve të fondeve të bankave. ii) niveli i aktiv-pasiveve afatshkurtra. iii) niveli i burimeve të fondeve nga të tretët sipas maturitetit të mbetur. iv) një pasqyrë e fluksit të rrjedhjes së parave (<i>cash flow-t</i>). v) vlera e aktiveve të titullzuara (nëse ka) etj

Tabelë 16: Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës së huaj (çdo muaj)

Nr.	Depozita ekuivalente e kapitalit (DEK-a) :	Shuma
1.	Depozitë në Bankën e Shqipërisë me normë interesi të përcaktuar me marrëveshje midis tyre.	
2.	Bono thesari dhe obligacione të emetuara nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.	
3.	Tituj të emetuar nga Banka e Shqipërisë.	
	SHUMA	

Tabelë 17: Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës së huaj (çdo tremujor)

Kodi	Treguesit (në mijë lekë)	
1	Totali i aktiveve në fund të tremujorit paraardhës	
2	Teprica e kredisë e tremujorit raportues	
3	Raporti tepricë kredie / total i aktiveve (në %) (2:1 x100)	
4	Kufiri maksimal i rrezikut	70%

Tabelë 18: Politikat e shpërblimit (çdo fund viti)

Informacion cilësor		
	(a)	<p>Informacion përmbledhës mbi komitetin e shpërblimit (nëse ka)/njësinë përgjegjëse që përcakton politikat e shpërblimit, që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> i) emrin, përbërjen dhe mandatin e komitetit të shpërblimit (nëse ka) / njësisë përgjegjëse për përcaktimin e politikave të shpërblimit; ii) një përshkrim të qëllimit të politikës së shpërblimit të bankës (për shembull sipas linjave të biznesit), duke përfshirë dhe deri

		<p>në çfarë masë janë të aplikueshme për filialet dhe degët e huaja;</p> <p>iii) një përshkrim për kategorinë e punonjësve që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë si dhe drejtuesit ekzekutivë, duke përfshirë dhe numrin e punonjësve në secilin grup.</p>
	(b)	<p>Informacion përmbledhës në lidhje me hartimin dhe strukturimin e procesit të përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve që përfshin:</p> <p>i) objektivat e politikës së shpërblimit;</p> <p>ii) rishikimin e politikave të shpërblimeve gjatë vitit të kaluar (nëse ka), shoqëruar me një përshkrim të ndryshimeve që janë bërë;</p> <p>iii) procedurën e ndjekur nga banka për të siguruar se politikat e shpërblimit të punonjësve që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë, dallojnë nga pjesa tjetër e punonjësve të bankës.</p>
	(c)	<p>Informacion përmbledhës mbi procedurat e bankës për vlerësimin e ndikimit të rrezikut aktual dhe rrezikut <i>ex-ante</i> në përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve, që përfshin:</p> <p>i) rreziqet që banka merr në konsideratë gjatë procesit të zbatimit të masës së shpërblimit;</p> <p>ii) masat kryesore të përdorura për të vlerësuar rreziqet, përfshirë këtu dhe rreziqet e vështira për t'u matur, si dhe ndikimin e tyre në politikat e pagave dhe shpërblimeve.</p>
	(d)	<p>Informacion përmbledhës mbi mënyrën sesi banka lidh performancën gjatë periudhës së vlerësimit të saj (performancës) me nivelin e pagave dhe shpërblimeve, që përfshin:</p> <p>i) matësit kryesorë të performancës për bankën, për linjat kryesore të biznesit dhe për punonjësit;</p> <p>ii) masën (në %) e shpërblimit individual që varet nga performanca e përgjithshme e bankës dhe performanca individuale e çdo punonjësi;</p> <p>iii) masat që banka ndërmerr për të përshtatur politikat e shpërblimit, në rastet e performancës financiare negative.</p>
	(e)	<p>Informacion përmbledhës mbi mënyrën sesi banka lidh objektivat dhe performancën në periudhën afatgjatë, me nivelin e pagave dhe shpërblimeve.</p>
	(f)	<p>Informacion përmbledhës mbi format e ndryshme të elementit të ndryshueshëm të shpërblimit që banka përdor dhe arsyen e përdorimit të tyre. Një përshkrim nëse ky element i ndryshueshëm i shpërblimit ndryshon për punonjës apo grup punonjësish të caktuar, një përshkrim të faktorëve që përcaktojnë kombinimin e shpërblimit të ndryshueshëm dhe rëndësinë e secilit prej tyre.</p>
Informacion sasior		
	(g)	<p>Numrin e takimeve të mbajtura nga komiteti i shpërblimeve (nëse ka)/struktura përgjegjëse për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve gjatë vitit financiar dhe niveli i pagesës së anëtarëve të kësaj strukture.</p>
	(h)	<p>Shumat vjetore të agreguara të pagesave dhe shpërblimeve për këshillin drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë (sipas tabelës 19), si dhe format e</p>

	shpërblimit të tyre, duke argumentuar dhe shpjeguar përputhshmërinë e këtyre pagesave me politikat e administrimit të rrezikut, profilin e rrezikut të përcaktuar sipas objektivave afatgjatë të bankës.
--	--

Tabelë 19:** Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë (çdo fund viti)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale	Për periudha të kaluara
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
aksione		
të tjera		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
aksione		
të tjera		

** Kjo tabelë do të plotësohet më vete për a) Këshillin Drejtues dhe b) drejtuesit ekzekutivë.

Tabelë 20: Politikat kontabël (çdo tremujor)

Informacion cilësor	
	(a) Informacion përmbledhës mbi politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, në mënyrë që përdoruesi i informacionit të njohë si vlerësohen zërat e ndryshëm në këto pasqyra, për një interpretim të saktë të informacionit.
	(b) Informacion përmbledhës mbi politikat kontabël të përdorura për vlerësimin e aktiv - pasiveve, fondeve rezervë, të ardhurave etj.